



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Priljepe/Proclato Received/Delivety	09.12.2021	1	viti qad Year
Organ / Shista Organ / Shista Org / Shit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shitja Punig Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	5934/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.982/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Arben Mehmeti- kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Koca anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.743/2019, të datës 02.12.2021, së ankuesit sipas Aktgjykimit A.nr.198/20 të datës 22.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative , me adresë banimi rruga Ndue Përlesh”, kompleksi Rrezja blloku II kati i III, nr. 12 Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “Ndërprerjeje e marrëdhënies se punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 09.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.743/2019, të datës 02.12.2019, së ankuesit sipas Aktgjykimit A.nr.198/20 të datës 22.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.
- II. MBETET NË FUQI, Vendimi i datës 04.11.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ar sy e t i m

Ankuesi me datë 02.12.2019, me numër protokollit 5642, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.12.2019, me numër protokollit 5791/2019, ka njoftuar ankuesin se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A.nr 743/2019, të datës 02.12.2019, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 12.12.2019, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 16.11.2021, ka nxjerr Aktgjykimin A.nr. 198/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 12.12.2019, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr. 743/2019, të datës 02.12.2019 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.743/2019, të datës 02.12.2019 me numër protokollit 5642/2019, të ankuesit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Aktgjykimi A.nr.198/20 i datës 22.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi PKR. NR. 202/2019, i datës 30.08.2019, i Gjykatës Themelore Departamenti i Krimeve të Rënda; kërkesë e datës 23.10.2019; Vendimi i datës 04.11.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimi i datës 26.11.2018, lidhur me pezullimin parandalues; Përgjigje në ankesë e datës 12.12.2019, me numër protokollit 5801/2019, me shkresat e bashkangjitura, Njoftimi i datës 12.12.2019, për ankuesin Lavdim Rexhepi, nga KPMSHCK-ja.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar Aktgjykimin A.nr.198/20 të datës 16.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 02.12.2019, të KPMSHCK-së, me të cilin aktgjykim KPMSHCK-në e ka obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr. 743/2019, të datës 02.12.2019 të ankuesit



Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit Kolegji konstaton se sipas Vendimit të datës 26.11.2018, Drejtori i Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, ankuesin e ka pezulluar me 50% të pagës bazë deri në marrjen e vendimit përfundimtarë nga ana e Gjykatës, me arsyetimin se gjykata kompetente me datë 25.11.2018, ndaj ka urdhëruar arrestin shtëpiak. Ndërsa Gjykata Themelore Departamenti për Krime të Renda në Prishtinë, me datë 30.08.2019 ka nxjerr aktgjykimi A.PKR. Nr. 202/2019, me të cilin aktgjykim ankuesin e ka shpallë fajtor për veprën penale marrje e ryshfetit nga nenin 428, paragrafi 1, të KPRK-së, me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muaj (6) dhe dënim me gjobë me shumën prej (3000) tre mijë euro.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me datën 04.11.2019, me numër protokoll 982, ka nxjerr vendim me të cilin ka ndërprerë marrëdhënien e Punës në Shërbimin Civil", pasi që Gjykata Themelore Departamenti për Krime të Renda në Prishtinë, ka nxjerr aktgjykimin A.PKR.Nr.202/2019, dhe është shpallur fajtor për veprën penale marrje e ryshfetit nga nenin 428, paragrafi 1, të KPRK-së, me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muaj (6) me burgim dhe dënim me gjobë me shumën prej (3000) tre mijë euro. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies se punës nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, janë të pabazuara në legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, në rastin e nxjerrjes se vendimit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies se punës për nëpunësin civil ka vepruar në pajtim 60, paragrafi 1, nen paragrafi 1.5 dhe 1.6, të Ligjit Nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: **1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: dënohet me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër.** Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi që ka shqyrtuar ankesën e ankuesit ka konstatuar se nga shkresat e lëndës del se Gjykata Themelore Departamenti për Krime të Renda në Prishtinë, përmes aktgjykimit, PKR. Nr. 202/2019, ka shpallur fajtor, nëpunësin Civil për veprën penale marrje e ryshfetit nga nenin 428, paragrafi 1, të KPRK-Së, me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muaj (6) dhe dënim me burgim dhe me gjobë me shumën prej (3000) tre mijë euro, dhe ky aktgjykim me datën 09.10.2019, është bërë i plotfuqishëm dhe në këtë periudhë ka qenë në fuqi Ligji Nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, prandaj kolegji konstaton se në rastin konkret Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore e Kosovës, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies se punës, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit Nr. 06/L - 114 për zyrtarët publik nga se në nenin 32 paragrafi 3 shprehimisht përcaktohet : " Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji ", andaj mbi këtë bazë vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës është në harmoni më legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Vendimi për pezullimin e pagës me 50%, të pagës për ankuesin është nxjerr duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga se ky ligj ka qenë në fuqi në këtë kohë, ndërsa ndërprerja e marrëdhënies së punës për ankuesin është bërë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, prandaj Kolegji konstaton se ndaj ankuesit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, është vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe se ky vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës rezulton mbi bazë të aktgjykimit A.PKR. Nr. 202/2019 të datës 30.08.2019, të Gjykatës Themelore Departamenti për Krime të Renda në Prishtinë, i cili aktgjykim me datë 09.10.2019, është bërë i plotfuqishëm, andaj mbi këtë bazë organi i punësimit ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe vendimi është i bazuar drejtë në aspekt juridikë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.982/2021, datë 09/12/2021

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së